L I G J
Nr.9493, datë 13.3.2006

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES FINANCIARE NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE ARTIGIANCASSA S.P.A. PËR FINANCIMIN E PROGRAMIT "PËR PESË POLIKLINIKA NË QYTETET E TIRANËS, GJIROKASTRËS, KORÇËS DHE PESHKOPISË""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Artigiancassa S.P.A. për financimin e programit "Për pesë poliklinika në qytetet e Tiranës, Gjirokastrës, Korçës dhe Peshkopisë"", me një kredi të butë prej 5 080 000 eurosh.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4821, datë 28.3.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

F.ROT./AID-04/009/00

MARRËVESHJE FINANCIARE
MIDIS KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE ARTIGIANCASSA S.P.A.
EURO 5.080.000,00
PROGRAMI PËR PESË POLIKLINIKAT NË QYTETET E TIRANËS,
GJIROKASTRËS, KORÇËS DHE PESHKOPISË

- Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (këtu dhe më tej, duke iu referuar si "Huamarrësi"), i përfaqësuar nga Ministria e Financave, në njërën anë, dhe
- Artigiancassa S.P.A.,e listuar në Regjistrin e Bankave, me kapital aksionar prej 35 000 000,00 euro, me seli në Romë, Via Crescenzo del Monte 25, e regjistruar në Regjistrin e Shoqërive, me kod fiksal

nr. 01158450583, TVSH nr. 00968081000 (këtu dhe më tej duke iu referuar si "Artigiancassa"), si administratori i Fondit Qarkullues për Bashkëpunim Zhvillimi, i krijuar sipas nenit 26 të ligjit italian nr.227 të 24 majit 1977 në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave të Italisë dhe, më tej duke iu referuar atij në nenin 6 të ligjit italian nr.49 të 26 shkurtit 1987 përfaqësuar nga z.Carlo Larcinese, në anën tjetër,

(Artigiacassa dhe Huamarrësi, së bashku, këtu dhe më tej, duke iu referuar si "Palët"),

kanë vendosur të hyjnë në këtë Marrëveshje financiare.

Neni 1

Përkufizime

Në këtë Marrëveshje dhe në shtojcat e saj, termat në vazhdim do të kenë kuptimet si vijojnë:

- "Njohja e të qenit në borxh": do të thotë deklarimi, të cilit i bëhet referencë sipas nenit 10, me të cilin Huamarrësi merr përsipër, në favor të Artigiancassa, të rimbursojë njëkohësisht kapitalin së bashku me interesin, të cilët janë detyrim sipas Kredisë së Butë;
- "Banka Agjente": do të thotë institucioni financiar (Artigiancassa), i cili do të jetë i përfshirë në aktivitetet që vijojnë:
- verifikim i dokumentacionit kontraktual;
- veprime disbursimi;
- veprime pagesash.
- "Marrëveshje": do të thotë Marrëveshja financiare në fjalë, pjesa hyrëse dhe shtojcat e saj, të cilat janë pjesë integrale të vetë asaj;
- "Banka shqiptare": do të thotë banka vendase e emëruar nga Huamarrësi, si bankë korrespondente e Artigiancassa, e cila vepron si Bankë Agjente për qëllime të kësaj Marrëveshjeje;
- "Dokumentacioni kontraktual": do të thotë dokumentacioni të cilit i bëhet referencë në kontratën/at e furnizimit (p.sh. faturat, fleta e ngarkesës, lista e paketimit, situacione punimesh etj.);
- "Periudha e faljes": do të thotë periudha që zgjat 204 muaj, që fillon nga data e disbursimit të parë;
- "Autoritetet kompetente italiane": do të thotë Ministria e Ekonomisë dhe e Financave dhe/ose Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Italisë dhe/ose ndonjë ent tjetër kompetent i Republikës së Italisë, i emëruar për qëllime të kësaj Marrëveshjeje;
- "MPJ/DPBZH": do të thotë Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Italisë - Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunim Zhvillimi;
- "Programi": do të thotë projekti i lidhur me: "Programi për pesë poliklinikat në qytetet e Tiranës, Gjirokastrës, Korçës dhe Peshkopisë", për të cilin është rënë dakord ndërmjet Qeverisë së Republikës Italiane dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, në rrjedhim të Marrëveshjes Qeveritare, pjesërisht e financuar me mjete nga Kredia e Butë;
- "Njësia e zbatimit të projektit(NJZP)": do të thotë njësia teknike e krijuar pranë Ministrisë shqiptare të Shëndetësisë, e cila do të ofrojë koordinimin e funksioneve teknike dhe menaxheriale, të nevojshme për realizimin e programit;

- "Kredi e Butë": do të thotë financimi, të cilin Artigiancassa do të japë sipas termave dhe kushteve të parashikuara në nenin 1 dhe në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje, mbi bazën e autorizimit të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave dhe mbi propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme;
- "Kontrata(t) e furnizimit": do të thotë kontrata(at) tregtare që kanë të bëjnë me furnizimin e mallrave dhe/ose shërbimeve nga ana e eksportuesve italianë tek importuesit shqiptarë, të lidhura me realizimin e programit.

Neni 2

Pjesa hyrëse

2.1 Përmes marrëveshjes së njohur si "Marrëveshje Qeveritare" (këtu dhe më tej duke iu referuar si "Marrëveshja Qeveritare ") e nënshkruar më 17 maj 2004 ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë, kjo e fundit është angazhuar ta financojë programin përmes një kredie të butë deri në një shumë maksimale prej 5 080 000,00 (pesë milionë e tetëdhjetë mijë) euro;

2.2 Përmes kësaj Marrëveshjeje, palët kanë ndërmend të: (i) zbatojnë parashikimet financiare,

lidhur me Kredinë e Butë, të caktuara më parë në Marrëveshjen Qeveritare dhe (ii) të rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre në përputhje me Marrëveshjen Qeveritare.

2.3 Ministria e Ekonomisë dhe e Financave e Qeverisë së Republikës të Italisë, bazuar në propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Italisë, me dekretin nr. 79144, datë 18 korrik 2005 ka autorizuar Artigiancassa t'i japë Huamarrësit një kredi të butë, sipas termave dhe kushteve të caktuara më parë në nenet 3 dhe 6 të kësaj Marrëveshjeje (këtu dhe më tej duke iu referuar si "Kredia e Butë") për qëllimin e financimit të programit.

2.4 Artigiancassa, për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, do të veprojë gjithashtu si Bankë Agjente dhe Banka Amerikane e Shqipërise do të jetë Banka Shqiptare.

Neni 3

Kredia e Butë

3.1 Artigiancassa i jep Huamarrësit dhe Huamarrësi, me këtë, pranon Kredinë e Butë, sipas kushteve që vijojnë :

- Shuma: deri në një maksimum prej 5 080 000,00(pesë milionë e tetëdhjetë mijë) euro;
- Kohëzgjatja: 38 vjet;
- Ripagimi: me 42 (dyzet e dy) këste të njëpasnjëshme, të barabarta, çdo gjashtëmujor, të principalit, i pari i të cilëve kthehet në detyrim për t"u paguar 210 (dyqind e dhjetë) muaj nga data e disbursimit të parë;
- Norma e interesit: nominale, vjetore, 0.10% (zero pikë dhjetë për qind), e pagueshme në fund të çdo periudhe 6 (gjashtë) mujore nga data e secilës tërheqje;
- Qëllimi i kredisë:"Programi për pesë poliklinikat në qytetet e Tiranës, Gjirokastrës, Korçës dhe Peshkopisë".

3.2 Kredia e Butë do të përdoret për përfitimin e mallrave dhe shërbimeve me origjinë italiane. Një shumë maksimumi sa 30% (tridhjetë për qind) e shumës së lidhur me Kredinë e Butë, mund të përdoret për të mbuluar kostot lokale dhe importe të mallrave dhe shërbimeve me origjinë nga vende të tjera në zhvillim.

Në mënyrë të veçantë, secila kontratë që lidhet me kostot lokale dhe importet e mallrave dhe shërbimeve me origjinë nga vende të tjera në zhvillim do të negociohet nëpërmjet, dhe do të nënshkruhet vetëm nga kontraktori/eksportuesi italian kryesor.

Kontratat e furnizimit do të jenë të përcaktuara në euro.

3.3 Kredia e Butë nuk mund të përdoret për të financuar:

taksat lokale, detyrimet doganore, TVSH-në.

3.4 Kontratat e furnizimit, të lidhura me programin sipas nenit 2.1, do të prokurohen përmes tenderave publikë të rezervuar për shoqëritë italiane mbi bazën e procedurave të parashikuara për këtë në "Manualin e Procedurave"(i përafruar nga Komisioni Europian më 23 dhjetor 2002) lidhur me shërbimet, furnizimet dhe kontratat e punimeve të financuara nga buxheti i përgjithshëm i KE-së në kuadrin e bashkëpunimit me vendet e treta.

3.5 Kredia e Butë do të jetë e disponueshme në përputhje me termat dhe kushtet e caktuara më parë në këtë Marrëveshje.

Neni 4

Hyrja në fuqi e Marrëveshjes financiare

4.1 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi, sapo Artigiancassa të ketë marrë nga Huamarrësi dokumentet e mëposhtme, përmes Ambasadës Italiane- L'Ambasciata / UTL:

i) Një deklaratë nga autoriteti kompetent i Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, i cili provon autoritetin e Huamarrësit për ta nënshkruar, në emër dhe për llogari të Qeverisë shqiptare, këtë Marrëveshje nga një person plotësisht i autorizuar, në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi dhe me efekt të plotë në Shqipëri dhe të marrë përsipër detyrimet që rrjedhin prej kësaj Marrëveshjeje;

ii) Caktimin, me shkrim, nga autoriteti kompetent i Huamarrësit, të personit/ave plotësisht të autorizuar për ta nënshkruar këtë Marrëveshje (e certifikuar nga Ambasada Italiane në Tiranë – L'Ambasciata / UTL), kërkesen për financim të kontratave të furnizimit sipas formularit në shtojcën A dhe "Njohjen e të qenit në borxh" sipas formularit në shtojcën C së cilës i bëhet referencë sipas nenit 10 më poshtë. Ky caktim do të specifikojë emrin dhe pozitën e personit/ave dhe do të përmbajë të përditësuar depozitimin e nënshkrimeve të tyre.

Çdo modifikim ndaj saj (nëse do të ketë) do të transmetohet në kohë nga Huamarrësi te Artigiancassa.

4.2 Artigiancassa do të njoftojë Huamarrësin dhe Bankën Shqiptare, me letër ose me faks, për datën në të cilën kjo Marrëveshje do të bëhet efektive, sapo të ketë marrë, dhe në mënyrë plotësisht të kënaqshme, dokumentacionin e lartpërmendur, e cila do të ndiqet prej një konfirmimi me letër.

Neni 5

Termat për disbursimin e Kredisë së Butë

5.1 Periudha e disbursimit të Kredisë së Butë është 36 (tridhjetë e gjashtë)muaj nga data e disbursimit të parë. Kjo periudhë mund të zgjatet nga ana e Artigiancassa. Artigiancassa nuk mund ta zgjasë periudhën e disbursimit, në rast se Huamarrësi ose Autoritetet Kompetente Italiane nuk bien dakord për një zgjatje të tillë dhe kanë njoftuar me shkrim për Artigiancassa, të paktën 30 (tridhjetë)ditë kalendarike para skadimit të periudhës së disbursimit.

5.2 Në rastin kur periudha e disbursimit ka skaduar dhe është e pazgjatshme, Artigiancassa, pasi ta ketë konsultuar këtë me Autoritetet Kompetente Italiane, do të informojë Huamarrësin për anulimin e angazhimit të Artigiancassa, për sa u takon fondeve të papërdorura.

Neni 6

Kushtet dhe mënyrat për disbursimin e Kredisë së Butë

6.1 Kredia e Butë mund të përdoret nga Huamarrësi me përmbushjen e kushteve që vijojnë:

i) autorizimi i dhënë prej Autoriteteve Kompetente Italiane, për shpërndarjen e kontratës/ave në Kredinë e Butë;

ii) rezultat pozitiv nga verifikimi i bërë nga Artigiancassa sipas nenit 6.2(1) më poshtë;

iii) marrja nga ana e Artigiancassa e kërkesës për financimin e kontratës së furnizimit të parashikuar sipas nenit 7.1 si më poshtë.

6.2 Me marrjen prej Artigiancassa të autorizimit të përmendur në nenin 6.1(i) si më sipër, Artigiancassa do të veprojë menjëherë si më poshtë:

i) për të kryer kontroll, sipas kërkesave të parashikuara për këtë qëllim prej Autoriteteve Kompetente Italiane mbi eksportuesit italianë dhe mbi individët/shoqëritë, nëse ka, të përfshira me organizata vendase dhe mbi kontratën/at e furnizimit. Referuar kontratës/ave të furnizimit, Artigiancassa do të verifikojë nëse ato janë në përputhje me termat dhe kushtet e Kredisë së Butë dhe nëse janë të detajuara në mënyrë të mjaftueshme lidhur me kostot/çmimet, me qëllim që të lejojnë verifikimet e parashikuara në nenin 8.3;

ii) për të njoftuar Huamarrësin dhe Bankën Shqiptare për marrjen e autorizimit sipas nenit 6.1(i) si më sipër dhe t'i kërkojë Bankës Shqiptare, të paraqesë kërkesen, sipas parashikimit të bërë në nenin 7.1.

6.3 Rezultati pozitiv nga verifikimi i bërë nga Artigiancassa, siç parashikohet nga neni 6.2 (i) më sipër, do të çojë në akordimin e kontratës/ave të furnizimit në Kredinë e Butë. Financimi i kontratës së furnizimit do të kryhet vetëm pas plotësimit të kushtit të caktuar më parë te neni 6.1(iii).

6.4 Artigiancassa do të njoftojë me letër/faks Huamarrësin, Bankën Shqiptare, NJZP dhe eksportuesin italian, për akordimin si edhe për financimin e kontratës/ave të furnizimit.

Neni 7

Kërkesa për financimin e kontratës së furnizimit

7.1 Pas njoftimit të rezultateve pozitive të dala nga verifikimi sipas nenit 6.2(i), Huamarrësi do të transmetojë tek Artigiancassa një letërkërkese për financimin e kontratës së furnizimit, e nevojshme për të kryer pagesat, e parashikuar kjo në çdo kontratë furnizimi. Me anë të kësaj kërkese, e cila do të jetë sipas formularit në shtojcën A, Huamarrësi njeh atë që kontrata/at e furnizimit është/janë e/të kualifikuar/a për t'u financuar dhe do të marrë përsipër të rimbursojë Artigiancassa për shumën e disbursuar.

7.2 Letra e kërkesës për financimin e kontratës së furnizimit, e parashikuar në nenin 7.1, do të merret në një kohë të shpejtë dhe në asnjë rast më vonë se 6(gjashtë) muaj nga data e njoftuar nga Artigiancassa parashikuar sipas nenit 6.4 më sipër ose në kohën(nëse ekziston) e parashikuar për të në kontratën e furnizimit. Pas skadimit të periudhës së lartpërmendur, Artigiancassa, pas konsultimit me Autoritetet Kompetente Italiane, do të marrë në konsideratë anulimin e mundshëm të kontratës/ave tregtare të akorduara në kuadrin e Kredisë së Butë.

Neni 8
Disbursimet

8.1 Kërkesa për financimin e secilës kontratë furnizimi, parashikuar në nenin 7, do të kryhet nga lidhja e Bankës Shqiptare me çdo pagesë për t'u kryer, në përputhje me kushtet e parashikuara për këtë në kontratën e furnizimit, me paraqitjen e dokumentacionit kontraktual.

8.2 Eksportuesi italian do të lëvrojë dokumentacionin kontraktual dhe do të kërkojë disbursimin e shumës përkatëse në përputhje me kontratën e furnizimit, sipas formularit në shtojcën B. Një kopje origjinale e dokumentacionit kontraktual do të dërgohet në të njëjtën kohë nga Artigiancassa te Banka shqiptare dhe te NJZP.

8.3 Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh kalendarike nga data e dërgimit nga Artigiancassa të dokumentacionit kontraktual të sipërpërmendur, NJZP do të njoftojë me një komunikim me shkrim Artigiancassa dhe për dijeni një kopje Bankës Shqiptare, për përputhshmërinë me dokumentacionin kontraktual përkatës të mallrave dhe/ose shërbimeve të furnizuara.

8.4 Në vijim të marrjes së çdo kërkese për disbursim, Artigiancassa do të ekzaminojë dokumentacionin kontraktual. Një ekzaminim i tillë do të përfshijë përputhshmërinë e dokumentacionit kontraktual me kontratën e furnizimit në fjalë.

8.5 Artigiancassa, pas rezultatit pozitiv nga verifikimi i parashikuar sipas nenit 8.3 dhe rezultatit pozitiv nga ekzaminimi i parashikuar sipas nenit 8.4, do të disbursojë shumën në fjalë në llogarinë brenda 45 (dyzet e pesë) ditësh kalendarike nga data e marrjes së çdo kërkese për disbursim dhe do të konfirmojë me teleks ose me faks në Bankën Shqiptare dhe në Ministrinë e Financave, shumën totale të disbursimit dhe datën në të cilën fondet i janë kredituar eksportuesit/ve italian/ë.

8.6 Artigiancassa do të kryejë pagesat në favor të eksportuesit/ve italian/ë dhe do të marrë prej këtyre eksportues/ve, vërtetimin për faturën e paguar të detyrimit, e parashikuar në shtojcën D në dy origjinale, njëra prej të cilave do t'i dërgohet Bankës Shqiptare.

8.7 Duke ndjekur çdo pagesë në favor të eksportuesit/ve italianë, Artigiancassa do t'i dërgojë Huamarrësit dhe Bankës Shqiptare një grafik të përditësuar të ripagimit, i cili tregon të gjitha shumat e disbursuara deri atëherë duke përfshirë dhe disbursimin e fundit, duke shënuar datat detyrim për pagesë që lidhen me to në përputhje me nenin 9 më poshtë. Huamarrësi do të konfirmojë me shkrim pëlqimin e tij për grafikun e ripagimit të lartpërmendur.

Neni 9
Ripagimi i Kredisë së Butë dhe pagesa e interesit

9.1 Çdo shumë e disbursuar do të ripaguhet sipas grafikut të ripagimit në 42 (dyzet e dy) këste të njëpasnjëshme, të barabarta, çdo gjashtëmujor (këtu dhe më tej duke iu referuar si "Këste të Principalit"), i pari nga të cilët bëhet detyrim për t'u paguar 210 (dyqind e dhjetë) muaj pas datës së disbursimit të parë. Artigiancassa do t'i dërgojë Huamarrësit dhe Bankës Shqiptare, grafikun e ripagimit, në përputhje me nenin 8.7.

9.2 Mbi kështet e principalit të mbetura pa ripaguar dhe efektivisht të kredituara, interesi i mbetur do të përllogaritet sipas një norme nominale vjetore prej 0.1 %(zero pikë një për qind), të barasvlefshme me 0.05% (zero pikë zero pesë për qind) gjysmëvjetore, nga data në të cilën janë kredituar fondet deri në datën e ripagimit të këstit të fundit të principalit. Interesi do të përllogaritet bazuar në numrin e ditëve efektivisht të kaluara duke marrë për bazë një muaj me tridhjetë ditë dhe një vit me treqind e gjashtëdhjetë ditë (30/360).

9.3 Gjatë periudhës së ripagimit, interesi do të paguhet në të njëjtat data detyrim për pagesë të kësteve të principalit. Gjatë periudhës "Grace", interesi do të paguhet çdo 6(gjashtë) muaj në datat të cilat korrespondojnë si ditë dhe si muaj me datat e ripagimit të kësteve të principalit. Kësti i parë i pagesës së interesit mund të jetë i lidhur me një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj. Sidoqoftë, nëse kjo periudhë do të jetë më pak se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike, kësti i interesit i cili i korrespondon asaj, do të paguhet së bashku me kështin ndjekës të interesit. Kësti i parë i interesit, i lidhur me një periudhë prej më shumë se gjashtë muaj ose më pak se gjashtë muaj, do të përllogaritet mbi bazën e ditëve faktike që kalojnë ndërmjet datave të pagesës së tij duke marrë për bazë një periudhë gjashtëmujore me 180(njëqind e tetëdhjetë) ditë

kalendarike.

9.4 Pagesa e interesit të lidhur me çdo disbursim do të kryhet në datat kur ai është detyrim, të treguara këto në grafikun e ripagimit, të përcaktuara më parë në nenin 8.7, deri në datën e lëshimit të "Njohjes së të qenit në borxh" e referuar kjo në nenin 10 më poshtë; për periudhën në vijim ripagimi i principalit dhe pagesa e interesit do të kryhet në datat detyrim të treguara në grafikun e ripagimit, bashkëlidhur "Njohjes së të qenit në borxh", të lartpërmendur.

9.5 Banka Shqiptare, në emër dhe për llogari të Huamarrësit, merr përsipër të kryejë pa vonesë të gjitha pagesat dhe ripagimin detyrim sipas kësaj Marrëveshjeje, si dhe sipas "Njohjes së të qenit në borxh", në datën aktuale të detyrimit, për shumën korresponduese në euro në favor të Artigiancassa ose të personit/ave të përcaktuar për këtë. Këto shuma do të kreditohen pa asnjë zbritje të ndonjë komisioni bankar dhe/ose valutor dhe fiskal dhe pa qenë nevoja për njoftim për këtë nga Artigiancassa, ose prej të personave të caktuar të cilëve iu është kërkuar.

Neni 10

Lëshimi i "Njohjes së të qenit në borxh"

10.1 Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh kalendarike nga data e fundit e skadimit të disbursimit të Kredise së Butë i caktuar më parë në nenin 5.1, Huamarrësi do të lëshojë për Artigiancassa, "Njohjen e të qenit në borxh", të nënshkruar rregullisht dhe të sigluar në çdo faqe, sipas formularit në shtojcën C.

10.2 Grafiku i ripagimit, i përcaktuar më parë në "Njohjen e të qenit në borxh", do të kompletohet duke mbledhur të gjitha këstet e principalit dhe të interesit të pamaturuara ende, dhe këstet që janë maturuar, por nuk janë paguar ende në datën e lëshimit të "Njohjes së të qenit në borxh", e parashikuar në grafikun përkatës të ripagimit për çdo disbursim, në përputhje me parashikimet e nenit 8.7.

10.3 Artigiancassa do të depozitojë "Njohjen e të qenit në borxh", për arkivim dhe administrim, dhe kohë pas kohe do të evidentojë në "Njohjen e të qenit në borxh" çdo ripagesë të principalit dhe të interesit së bashku me këste që mund të jenë maturuar, por nuk janë paguar. Sapo, të gjitha pagesat e parashikuara në "Njohjen e të qenit në borxh" të jenë kryer, Artigiancassa do t'i kthejë Huamarrësit, të firmosur rregullisht "Njohjen e të qenit në borxh", si provë e kryerjes së ripagimit.

Neni 11

Angazhimi i Huamarrësit

11.1 Angazhimi i Huamarrësit, për të paguar shumat detyrim, sipas kësaj Marrëveshjeje dhe sipas "Njohjes së të qenit në borxh" lidhur me të, është i pavarur, absolut, i pakushtëzuar dhe i pakthyeshëm.

Neni 12

Rreziqet dhe forca madhore

12.1 Në rast të rreziqeve ndaj zbatimit të programit për shkak të forcave madhore (të tilla, si: lufta, përmbytjet, zjarri, tërmeti, konflikte pune dhe greva, veprime të qeverisë, vështirësive të papritura të transportit, punës dhe shkaqe të tjera) do të zbatohen dispozitat e specifikuara në Marrëveshjen Qeveritare. Artigiancassa do të ndjekë udhëzimet e Autoriteteve Kompetente Italiane në lidhje me veprimtaritë e programit.

Neni 13

Pezullimi i disbursimeve

13.1 Gjatë periudhës së disbursimit të Kredisë së Butë, Artigiancassa ruan të drejtën të pezullojë çdo kërkesë për disbursim sipas nenit 8, në rastin e ndonjë dështimi për të vepruar kundrejt Artigiancassa, sipas kësaj Marrëveshjeje apo kreditesh të tjera financiare të dhëna nga Qeveria e Republikës së Italisë për Qeverinë ose për Bankën Qendrore ose për Agjenci Shtetërore të Republikës së Shqipërisë në zbatim të nenit 6 të ligjit nr.38 të 9 shkurtit 1979 dhe të nenit 6 të ligjit nr.49 të 26 shkurtit 1987 të Republikës së Italisë, me ndryshimet e pësuara. Artigiancassa do të informojë, rast pas rasti, Huamarrësin dhe Bankën

Shqiptare për një pezullim të tillë.

13.2 Artigiancassa do të ekzekutojë çdo kërkesë për disbursim siç është parashikuar në nenin 8, në rast se shumat korresponduese janë bërë të disponueshme nga Autoritetet Kompetente Italiane. Artigiancassa nuk do të quhet përgjegjëse kundrejt Huamarrësit në rast se shumat për t'u disbursuar në kuadrin e Kredisë së Butë, nuk do të jenë bërë të disponueshme nga Autoritetet Kompetente Italiane.

Neni 14
Interesvonesa

14.1 Nëse për ndonjë arësye, çfarëdoqoftë, Artigiancassa nuk merr shumat detyrim për principalin dhe/ose interesin në datën kur ato janë detyrim për t'u paguar, Huamarrësi do të jetë i detyruar t'i paguajë Artigiancassa, mbi shumën e përmendur, interesvonesa, që nga data e detyrimit deri në datën e kreditimit efektiv në favor të Artigiancassa ose të personit/ave të caktuar për këtë.

14.2 Ky interesvonesë, që rrjedh nga dështimi për të vepruar, do të përllogaritet duke zbatuar formulën e interesit të thjeshtë me një normë prej 0,1% (zero presje një për qind) për periudhën prej 35 (tridhjetë e pesë) ditë kalendarike, menjëherë vijuese, nga data origjinale e detyrimit, dhe më pas, me një normë prej 2,6% (dy presje gjashtë për qind) deri në datën e kreditimit efektiv të Artigiancassa. Ky i dyti do të përditësohet nga Autoritetet Kompetente Italiane; një përditësim i tillë do të ndodhë nga 1 janari 2007.

14.3 Rishikimi ka si qëllim sjelljen e interesvonesës në të njëjtën linjë me, dhe për asnjë arsye jo më të lartë se Norma Reference e Interesit Tregtar (NRIT) e publikuar çdo muaj nga OECD.

Neni 15
Taksat

15.1 Çdo taksë në fuqi në të tashmen apo në të ardhmen, që mund të jetë e detyrueshme për pagesë në Shqipëri, për ndonjë arsye çfarëdo, lidhur me këtë Marrëveshje dhe me "Njohjen e të qenit në borxh", do të përballohet, ekskluzivisht, nga Huamarrësi.

15.2 Çdo taksë detyrim për t'u paguar në Itali, lidhur me këtë Marrëveshje, nuk do të përballohet nga Huamarrësi.

15.3 Artigiancassa deklaron se do të përfitojë nga statusi fiskal, i parashikuar sipas nenit 19 të dekretit nr. 601 të 29 shtatorit 1973 të Presidentit të Republikës, me ndryshimet e pësuara.

Neni 16
Ligji i zbatueshëm

16.1 Kjo Marrëveshje do të udhëhiqet e interpretohet në përputhje me ligjin italian.

Neni 17
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

17.1 Palët, këtu, do të bëjnë përpjekje për të zgjidhur në mirëkuptim çdo mosmarrëveshje që lind prej ose nga interpretimi dhe/ose realizimi i kësaj Marrëveshjeje.

17.2 Nëse këto përpjekje nuk do të çojnë, brenda një periudhe kohe të arsyeshme, në një zgjidhje të mosmarrëveshjes, atëherë mosmarrëveshja do të zgjidhet në nivel qeveritar.

17.3 Nëse edhe kjo përpjekje do të dështojë (nëse është tentuar) ose ajo nuk përfundon me një rezultat të kënaqshëm, të gjitha mosmarrëveshjet që lindin prej ose lidhen me këtë Marrëveshje, do të zgjidhen, përfundimisht, sipas Rregullores së Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris, Francë, nga një gjykatë arbitrazhi me tre arbitra:

- një arbitër i caktuar nga Huamarrësi;
- një arbitër i caktuar nga Artigiancassa;
- arbitri i tretë caktohet nga arbitrat e lartpërmendur ose, në rast të mosrënies dakord të tyre, prej kryetarit të Dhomës Tregtare Ndërkombëtare, Paris.

17.4 Nëse Huamarrësi ose Artigiancassa nuk caktojnë arbitrin e tyre brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga kërkesa e palës tjetër, ky arbitër do të caktohet nga kryetari i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris.

17.5 Vendimi i Gjykatës së Arbitrazhit, e cila do të vendosë sipas ligjit të Republikës së Italisë, do të jetë përfundimtar dhe pa kushte, i detyrueshëm për zbatim nga të dyja palët pa asnjë mundësi për ta apeluar.

17.6 Asnjë mosrënie dakord dhe asnjë mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve të këtushme, nuk mundet ta pezullojë detyrimin e Huamarrësit për të paguar, në datat detyrim, të rëna dakord, për të gjitha shumat detyrim sipas kësaj Marrëveshjeje dhe, veçanërisht, të gjitha shumat e rezultuara nga grafikët e ripagimit të caktuara më parë në nenin 8 më sipër dhe nga "Njohja e të qenit në borxh" e lidhur me të.

Neni 18
Komunikimet

18.1 Njoftimet për t'u bërë, në zbatim të kësaj Marrëveshjeje, do të adresohen si vijon:

- MINISTRIA E FINANCAVE: BULEVARDI "DËSHMORËT E KOMBIT", TIRANË, SHQIPËRI, Tel.: +355 -4- 250264 – Faks: +355 - 4- 228494

- BANKA AMERIKANE E SHQIPËRISË: RRUGA "ISMAIL QEMALI", NR.27, TIRANË
Tel: + 355 4 276000, Faks: +355 4 24 87 62

- ARTIGIANCASSA S.P.A. VIA CRESCENZO DEL MONTE, ROMË, ITALI, BËRTHAMA OPERATIVE LEX N.49/1987 N.TELEFONI 0039-06-5845529-561-414 TELEFAKS N. 0039-06-5845466

Neni 19
Tekstet origjinale të Marrëveshjes financiare

19.1 Kjo Marrëveshje financiare hartohet në tre origjinalë në anglisht.

FORMULARI I KËRKESËS PËR FINANCIMIN E KONTRATËS SË FURNIZIMIT)

Shtojca A

Nga : Banka Amerikane e Shqipërisë
Për : Artigiancassa S.p.a.

Marrëveshja financiare për……..... (….....) euro, e nënshkruar nga, në ……më …….dhe nga Artigiancassa në …….më ……

Në zbatim të nenit 7 të Marrëveshjes financiare të lartpërmendur, do të donim t'ju informojmë se kontrata e furnizimit, këtu bashkëngjitur, nr…… datë…… midis …….. dhe ……. lidhur me …….. (programin/projektin) është e kualifikuar për financim.

Si rrjedhojë, ne ju kërkojmë që të financoni shumën përkatëse prej euro …….. (……..), e cila i korrespondon pagesave, detyrim nga ana jonë, për ……..(eksportuesi italian), që ju do të duhet të kryeni në përputhje me termat e kontratës së furnizimit.

Për këtë qëllim, ne njohim faktin se pagesat që ju do të duhet të bëni në favor të eksportuesit italian, të treguara nga vetë ne, do të jenë subjekt i: (i) dorëzimit prej këtij eksportuesi të dokumenteve kontraktuale (si: faturat, fletëngarkesa, lista e paketimit, situacion i punimeve etj.); (ii) rezultatit pozitiv nga verifikimi i dokumenteve kontraktuale sipas nenit 8.3 dhe 8.5 të Marrëveshjes financiare ; (iii) dhe lëshimi i dokumentit të vërtetimit të faturës së paguar në dy kopje origjinale.

Në këtë kuptim, ju do të na dërgoni origjinalin e dokumenteve kontraktuale, si dhe dy origjinale të dokumentit të vërtetimit të faturës së paguar.

Me anë të kësaj, ne Ju konfirmojmë se Qeveria e ……. merr përsipër, pa kushte dhe në mënyrë të pakthyeshme, të ripaguaj, çdo shumë të kredituar nga Ju tek eksportuesit italianë, në përputhje me termat dhe kushtet e parashikuara sipas Marrëveshjes financiare.

Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga skadimi i afatit të fundit të disbursimit të Kredisë së Butë të caktuar më parë në nenin 5 të Marrëveshjes financiare, ne marrim përsipër të lëshojmë një "Njohje të të qenit në borxh" për shumën principale, e cila korrespondon me shumën e të gjitha disbursimeve të bëra sipas Marrëveshjes financiare.

Kjo “Njohje e të qenit në borxh” do të jetë sipas formularit në shtojcën C të Marrëveshjes financiare.

Juaji sinqerisht,

FORMULARI I KËRKESËS PËR DISBURSIM

Shtojca B

Nga: ……(Eksportuesi italian)
Për : Artigiancassa S.p.a.

Marrëveshja financiare për…… (…. ...) euro, nënshkruar nga …… në ……më …….dhe nga Artigiancassa S.p.a., në …….më ……

Të nderuar zotërinj

Duke iu referuar kontratës së furnizimit, nr. ……..datë …….mes nesh dhe …….(importues) për shumën prej …… (…. ...) eurosh lidhur me ……(programin /projektin), ne ju dërgojmë dokumentet kontraktuale që vijojnë:

……. …….
……. …….
……. …….
……. …….

Ne ju kërkojmë të disbursoni shumën e lartpërmendur brenda 45 ditëve nga dita e marrjes së kësaj kërkese në llogarinë bankare që vijon (Banka e eksportuesit italian).

BBAN …….. Çelur në emër të ……Banka: ……nr.telefoni i zyrës së degës …….. nr. Faks i zyrës së degës……

Juaji sinqerisht,

Datë …….....

Nënshkrimi

Ne, me këtë, konfirmojmë autenticitetin e nënshkrimit
…….....
(Banka e eksportuesit italian)

FORMULARI I NJOHJES SË TË QENIT NË BORXH

Shtojca C

…….....(Huamarrësi)

Nr. ……
Vendi dhe data e lëshimit:
……
Referuar Marrëveshjes financiare ndërmjet .....(Huamarrësi), i cili vepron në emër dhe për llogari të Qeverisë së …….....dhe Artigiancassa, e nënshkruar në ……. më ……..dhe në …….. më ……..... (Huamarrësi) njeh marrjen e shumave që vijojnë nga Artigiancassa :

…….....më ……..
…….....më……..
…….....më ……..

Për këtë, ……(Huamarrësi), me anë të kësaj, deklaron pa kushte dhe në mënyrë të pakthyeshme, të jetë debitor ndaj Artigiancassa, si administratore e Fondit Qarkullues për Bashkëpunim e Zhvillim, në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave(MEF) të Italisë - me seli në Romë (Itali), Via Crescenzo del Monte 25, për shumën principale prej …… (…. ...) eurosh, të cilën ai merr përsipër ta ripaguajë në ….....(….) këste të barabarta, gjashtëmujore, të njëpasnjëshme, i pari i të cilëve do të bëhet detyrim për t'u paguar më …… dhe i fundit më …… , sipas grafikut të ripagimit, të caktuar më parë, këtu dhe më poshtë.

Në shumën e veçantë të principalit të kësaj "Njohjeje të të qenit në borxh"……(Huamarrësi), merr përsipër të paguajë interesin të cilit i është bërë referencë në grafikun e ripagimit të caktuar më parë dhe këtu e më poshtë, i përllogaritur në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes financiare

……(Huamarrësi) do të ripaguajë këstet e pricipalit dhe interesin e parashikuar në këtë "Njohje të të qenit në borxh", duke kredituar shumat përkatëse në euro, në datën e detyrimit, rënë dakord, në favor të Artigiancassa ose të personit/ave të caktuar për këtë, me zyrën e degës në Romë të.....……, të zhveshur nga çdo tarifë shërbimi e bankës dhe/ose këmbimi.

Nëse, zyra e degës në Romë e....., për ndonjë arsye çfarëdo, duke përfshirë edhe për arsye jashtë kontrollit të Huamarrësit, nuk merr në datën e detyrimit, shumat detyrim për principalin dhe interesin, të parashikuara në "Njohjen e të qenit në borxh", Huamarrësi do të jetë i detyruar t'i paguajë zyrës së degës në Romë të....., interesvonesë mbi këto shuma, që nga data e detyrimit deri në datën e kreditimit efektiv në favor të Artigiancassa ose të personit/ave të caktuar për këtë.

Kjo interesvonesë do të përllogaritet me normën ..... për periudhën e ..... ditëve që vijojnë menjëherë nga data origjinale e detyrimit dhe më tej me normën ..... deri në datën e kreditimit efektiv në favor të Artigiancassa.

.....

(sigla e Huamarrësit)

vazhdon

Shtojca C vijon

Ky interes i fundit, i lidhur me dështimin për të vepruar, do të përditësohet nga autoritetet kompetente italiane.

Interesi për dështimin për të vepruar do të përllogaritet duke zbatuar formulën e interesit të thjeshtë.

Zyra e degës në Romë e .....do të shënojë, kohë pas kohe, në këtë "Njohje të të qënit në borxh", çdo pagesë të principalit dhe të interesit.

Menjëherë sapo të jenë kryer të gjitha pagesat e listuara në grafikun e ripagimit, i caktuar më parë dhe këtu e në vijim, kjo "Njohje e të qënit në borxh", do t'i kthehet .....(Huamarrësi).

Kjo "Njohje e të qënit në borxh" është lëshuar në zbatim të Kredisë së Butë prej …… (….....) eurosh, dhënë në përputhje me nenin 6 të ligjit nr.49 të 26 shkurtit, 1987.

GRAFIKU I RIPAGIMIT

Data e maturimit	Këste Principali	Këste Interesi	Shuma
a) ……	……	……	
b) ……	……	……..	
c) ……		……	……..
d) ……		……	……..
1) ……	……	……	……
2) ……	……	……	……
3) ……	……	……	……
4) ……	……	……	……

5) ……	……	……	……
6) ……	……	……	……
7) ……	……	……	……
8) ……	……	……	……
9) ……	……	……	……
10) ……	……	……	……

…….

(Nënshkrimi i Huamarrësit)

(FORMULARI I VËRTETIMIT PËR FATURË TË PAGUAR)

Shtojca D

Nga : Eksportuesi italian
Për: Bankën Amerikane të Shqipërisë
Për : Artigiancassa S.p.a.

VËRTETIM PËR FATURË TË PAGUAR

Duke iu referuar kontratës së furnizimit nr ……..nënshkruar më ..... mes shoqërisë sonë dhe .....…….për furnizimin e ……., ne, me anë të kësaj, konfirmojmë se kemi marrë shumën prej …… (…. ...) euro si pagesë e pjesshme/totale e kësaj kontrate furnizimi.

Kjo shumë lidhet me Kredinë e Butë prej…… (…. ...) eurosh, të dhënë nga Artigiancassa, për Qeverinë e ……, në zbatim të nenit 6 të ligjit nr.49 të 26 shkurtit 1987, me ndryshimet e pësuara, me anë të Marrëveshjes financiare të nënshkruar në …… më ……..dhe në .....më……

Ne, për këtë, me anë të kësaj, deklarojmë të jemi paguar tërësisht për shumën detyrim sipas Kredisë së Butë si pagesë për shumën prej .... eurosh dhe se Huamarrësi dhe Artigiancassa nuk janë përgjegjës për ndonjë apo për të gjitha komisionet dhe përgjegjësitë e lidhura me shumën e marrë.

Nënshkrimi
…….

Ne, me këtë konfirmojmë autenticitetin e nënshkrimit
……
Banka e eksportuesit italian